Pasqyrat financiare te shoqerise paraqiten te konsoliduara, duke perfshire Pasqyrat individuale te shoqerise Gjoka Konstruksion sha ne Shqiperi dhe Gjoka Konstruksion Sha ne Filialin Kosove.

**Ndryshime ne politikat kontabel**

Duke nisur nga 1 Janar 2011, Shoqeria ka ndryshuar politikat kontabël në paraqitjen e Pasqyrave Financiare duke aplikuar Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

**Ndryshime ne metodat e vleresimit kontabel**

Efektet e ndryshimeve ne vleresimin kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi (emuarja) eshte kryer. Nuk ka patur ndryshime ne politikat kontabel per vitin 2018.



REPUBLIKA E SHQIPERISE DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE DREJTORIA RAJONALE TATIMORE ... E TATIMPAGUESVE TE MEDHENJ

**Monedha Funksionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat**
Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e Shoqeria. Informacioni ne pasqyrat financiare eshte paraqitur ne Leke.

**Vlerësime dhe gjykime,**
Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të ketyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

**Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel**

**Instrumentat Financiare**
Instrumentat financiarë jo-derivativë te shoqerise përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke te tjera, hua të marra dhe të dhena, depozita bankare dhe llogari të pagueshme.
Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

**Njohja fillestare dhe cregjistrimi**
Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit ne fjale. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise perfundojne, skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.
Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

**Njohja e metejshme**

**Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuvalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat. Likuiditetet dhe vlera arke te tjera maten me tej me koston e amortizuar pakesuar me humbjet nga zhvleresimet.

**Vleresimi i likujditeteve**
Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogarite e arketueshme afatshkurtra nuk skontohen.
Provizioni per zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.
Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.
Kerkesat per arketim vleresohen me vleren nominale minus humbjen nga zhvleresimi. Ato nuk jane vleresuar me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv per te llogaritur vleren e interesit te paperfituar ne pasqyrat financiare perderisa nuk ka efekte materiale te ketyre interesave ne daten e mbylljes se bilancit.

**Llogari të pagueshme**
Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nese eshte materiale.

**Zhvleresime te aktiveve financiare.**
Nje aktiv financiar konsiderohet si i zhvleresuar ne ato raste kur ekzistojne kushte objektive qe tregojne se nje apo me shume ngjarje (pas njohjes se tij fillestare) kane efekte negative ne flukset e ardhshme te parase që parashikohet të burojnë prej atij aktivi.

Veshtiresite e konsiderueshme financiare te debitorit, propabiliteti qe debitori do te falimentoje apo nje riorganizim financiar, dhe pamundesia apo shkeljet ne pagesa konsiderohen si tregues qe nje llogari e arketueshme eshte e zhvleresuar.
Aktivet e rendesishme financiare testohen ne menyre individuale per zhvleresim. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, mbi baze grupesh që kanë karakteristika të ngjashme të riskut financiar (kreditor).
Humbja nga zhvleresimi lidhur me nje aktiv financiar te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diferenca midis vleres kontabel te aktivit dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parase, te skontuara me normen efektive te interesit te aktivit.
Vlera e nje aktivi zvogelohet nepermjet llogarise per zhvleresime dhe vlera e humbjes nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Te ardhurat nga interesi vazhdojne te rriten mbi vleren kontabel te aktualizuar, bazuar ne normen origjinale efektive te aktivit. Llogarite e arketueshme se bashku me fondin rezerve te zhvleresimit qe i shoqeron c'regjistrohen atehere kur nuk ka shpresa per rikuperim real ne te ardhmen.

**Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë**, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Nese ne nje vit pasues, shuma e humbjeve te vleresuara nga zhvleresimi rritet apo ulet per shkak te nje ngjarje pas njohjes fillestare te aktivit, humbja nga zhvleresimi i njohur me pare rritet apo reduktohet duke rregulluar llogarine e fondit rezerve te zhvleresimeve. Nese nje aktiv i cregjistruar me pare, rikuperohet, ky rikuperim njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

**Zhvleresimi i Aktiveve jo-financiare,**

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.
Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**Të tjera**

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

**Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)**

**Njohja dhe matja**

Aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivit.

Kostoja e aktiveve te kualifikuara perfshin kostot e interesit te kryera gjate periudhave te ndertimit, nese ka, bazuar ne normen mesatare te maturimit te huadhenies.
Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndertimi tij.
Në rastet kur pjesë të një aktivi afat-gjate materiale kane jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

Ne rastin e prodhimit te produkteve ne kosto perfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve te pergjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese.

Kostot e inventarit jane perllogaritur duke u bazuar ne metoden e mesatares se ponderuar dhe perfshihen shpenzimet e kryera gjate blerjes se inventarit dhe e dergimit te tyre ne kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.
Gjendjet e Inventarit jane te rregjistruara dhe te vleresuara ne bilanc me vleren e drejte.
Vlera e realizueshme neto eshte çmimi i shitjes i perllogaritur gjate rrjedhes normale te biznesit, pa koston e perllogaritur te perfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

**Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vleresuar të cdo pjese të aktivit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.
Amortizimi kalohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.
Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe per punimet në proçes që nuk janë në funksionim.

Amortizimi per Aktiveve Afatgjata Jomateriale njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve duke perdorur metoden lineare mbi jetegjatesine e parashikuar te aktiveve te patrupezuara qe nga data qe jane te disponueshme per perdorim.

**Cregjistrimi**

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit.

Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumes se tyre te mbartur dhe merren parasysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te ushtrimit.

**Aktivet e Patrupezuara**

Aktivet e patrupezuara perfshijne liçensat dhe te drejtat per perdorim sic eshte çertifikata ISO.

**Njohja dhe Matja**

Liçensat dhe te drejtat e perdorimit paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvleresimi, nese ka.

**Shpenzimet pasuese**

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetem ne rastin kur shtojne perfitimet e ardhshme ekonomike te trupezuara ne aktivin specifik me te cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje ne momentin kur kryhen.

**KAPITALET E VETA**

Ne pasqyrat individuale te shoqerise Kapitalet e veta paraqiten si me poshte:

- Kapitali aksionar ne Shqiperi eshte 2.700.000.000 leke
- Zeri Ligjore eshte 180.697.594 leke
- Fitim i vitit ushtrimor 2018 eshte ne shumen 1.859.625.571 leke.

Kapitali i Filialit ne Kosove me shumen 2,500 euro (dymije e peseqind euro), shume e cila ne fund te vitit eshte konvertuar me kursin e dates 31/12/2018 te Bankes se Shqiperise (1/Euro=123.42 leke)= 308.550 leke. E gjithe shuma e Kapitalit te shoqerise eshte vleresuar me metoden e drejte ne Aksione me vlere nominale 1/Aksion eshte i barabarte me 1.000 Leke.

Me Vendim te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise u miratua shpemdarja e fitimit te realizuar gjate vitit ushtrimor 2017 ne Shqiperi dhe kalim ne Rezervat e Tjera per investime, mbeshtetur ne Ligjin nr. 9901, dt 14.04.2008 „Per tregtaret dhe shoqeritë Tregtare".
Fitimi i vitit Ushtrimor 2017 ne Shqiperi ne shumen 728.696.134 leke bashke me rezervat e tjera ne shumen 1.692.485.793 leke, u destinua ne:

- Kalim ne rezerva te tjera te shoqerise meme ne shumen 121.181.927 leke.
- Zmadhimi i kapitalit te shoqerise meme ne shumen 2.300.000 leke.

**Zhvleresimi (Renia ne vlere),**
Shoqeria vlereson ne çdo date raportimi nese ka premisa qe nje aktiv te zhvleresohet. Ne rast se evidentohet mundesia per zhvleresim, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Per aktivet e patrupezuara qe nuk jane te gatshme per perdorim, vlera e rikuperueshme perllogaritet ne çdo date te bilancit.

Nje zhvleresim njihet atehere kur vlera kontabel e nje aktivi apo vlera e flukseve qe do te gjeneroje, eshte me e madhe se vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e flukseve qe gjenerohen eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse te parase qe jane kryesisht te pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvleresimet njihen ne pasqyren e fitimeve dhe humbjeve.

**Huate**
Huate e marra cash nga institucionet financiare, nga shoqeria jane mbajtur me koston e amortizuar duke perdorur interesin e aplikuar ne kontratat e huave. Interesat e perllogaritura jane njohur ne pasqyren e te ardhura-shpenzimeve dhe si detyrim ne llogarine interesa te perllogaritura.

**Provizionet**
Nje provizion krijohet nese ekziston nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te kaluara; ekziston mundesia qe per shlyerjen e detyrimit dhe nese mund te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

Provizionet përcaktohen duke skontuar (nese eshte materiale) flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen ne çdo date bilanci dhe nese nuk ka me gjasa per daljen e ndonje fluksi parashe per shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet perdoren vetem per qellimin qe jane njohur fillimisht. Ato nuk njihen per humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushtezuara nuk njihen por paraqiten ne shenime kur jane sinjifikative.

**Konvertimi i monedhave te huaja**
Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilin eshte kryer transaksioni.
Aktivet dhe pasivet monetare ne monedhe te huaj ne daten e mbylljes se bilancit jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne daten e mbylljes se periudhes ushtrimore me 31/12/2018. Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe te huaj në datën e hartimit të bilancit jane si me poshte (ne LEK):

| Monedha | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| 1 EUR | 123.42 | 132.95 |
| 1 USD | 107.82 | 111.1 |

**Të ardhurat - Njohja**

Te ardhurat nga sherbimet regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne proporcion me perfundimin e sherbimit ne daten e raportimit.

Te ardhurat nga shitja e sherbimeve (Punimeve) qe lidhen me aktivitetin kryesor ne Shqiperi jane te deklaruara ne kohen e perfitimit te tyre, ku zene dhe peshen kryesore te aktivitetit te shoqerise. Keto zene 99.4% te te ardhurave gjithsej.
Krahasuar me nje vit me pare te ardhurat ne pasqyrat individuale ne Shqiperi jane shtuar me 1.978.963.566 leke ose 44% me shume se viti 2017.
Krahasuar me nje vit me pare te ardhurat ne pasqyrat e konsoliduara jane shtuar me 2.189.862.080 leke ose 48.7% me shume se viti 2017.

**Shpenzimet**

i. Shpenzimet operative (materialet e konsumuara) perbejne rreth 44% te shpenzimeve gjithsej te periudhes.
ii. Shpenzime personeli zene rreth 6% te shpenzimeve te pergjithshme, 6% jane shpenzime te amortizimit dhe 44% zene shpenzimet e tjera. .

Krahasuar me nje vit me pare shpenzimet ne pasqyrat individuale ne Shqiperi jane shtuar me 18%. Krahasuar me nje vit me pare shpenzimet ne pasqyrat e konsoliduara jane shtuar jane shtuar me 23%.

**Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi apo humbjet e vitit perbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve perveç rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe tatim fitimi per shpenzimet e panjohura.:

Pasqyrat financiare te konsoliduara paraqesin fitimin e realizuar ne Shqiperi dhe ne Kosove.
Duke qene se shkalla tatimore për tatimin mbi fitimin ne Shqiperi eshte 15 % dhe shkalla tatimore për tatim fitimin në Kosovë eshte 10%, ne pasqyrat financiare te konsoliduara referuar sipas ligjit Nr. 8483 dt 28.121998 " Për tatimin mbi të ardhurat", te ndryshuar tatimi mbi fitimin llogaritet per te ardhurat globale me shkallen e tatimit 15%.
Diferenca e paguar ne Kosove nuk eshte paraqitur ne deklaraten e tatimit mbi fitimin, por ne kete deklarate , ne Rubriken Tatim fitim me shkalle tjeter eshte pasqyruar diferenca e tatimit mbi fitimin prej 5%, ne shumen 392.988 leke.
Duke qene se ne Shqiperi tatohet vetem diferenca e tatimit per shkak te ndryshimit te shkalles tatimore, ne deklaraten e tatimit mbi fitimin te ardhurat dhe shpenzimet e ushtrimit jane plotesuar per te ardhurat dhe shpenzimet globale sipas pasqyrave te konsoliduara, ndersa tek te ardhurat dhe shpenzimet tatimore jane plotesuar te ardhurat dhe shpenzimet e realizuar vetem ne Shqiperi.

**Deklarata e Tatimit mbi fitimin eshte e plotesuar sipas tabeles se meposhtme:**

**Llogaritja e rezultatit**

| | Të ushtrimit 2018 | Tatimore 2018 |
|---|---|---|
| **Të ardhura** | **6,719,733,327** | **6,508,834,813** |
| Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri | 6,508,834,813 | 6,508,834,813 |
| Nga Filiali Kosovë | 210,898,514 | |
| | | |
| **Shpenzimet** | **4,523,344,456** | **4,320,305,706** |
| Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri | 4,320,305,706 | 4,320,305,706 |
| Nga Filiali Kosovë | 203,038,750 | |
| | | |
| **Shpenzimet e pazbritshme** | | **4,161,135** |
| Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri | | 4,161,135 |
| Nga Filiali Kosovë | | 0 |

**Rezultati**

| | |
|---|---|
| **Fitimi Para Tatimit** | **2,192,690,242** |
| Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri | 2,192,690,242 |

**Llogaritja e Tatimit mbi fitimin**

| | |
|---|---|
| **Tatim Fitimi me shkallën standarte 15%** | **328,903,536** |
| Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri 15% | 328,903,536 |
| | |
| **Diferenca 5 % Filiali Kosovë që paguhet në Shqipëri** | **392,988** |
| | |
| **Total tatim fitimi për tu paguar në Shqipëri** | **329,296,524** |

Shoqëria Audituese
**Alb Auditing& Co shpk**
Auditues Ligjor
**Albana CANAJ**
Nr lic 372

Tirane, me 28.03.2019

*Pasqyrat individuale te aktivitetit ne Shqiperi e Kosove dhe Pasqyrat financiare te konsoliduara te shoqerise Gjoka Konstruksion shpk jane pjese perberese e ketij Raporti Auditimi.*

*Shoqeria "Alb Auditing & CO shpk, NIPT L91329013A, Auditues Ligjor Albana Canaj, nr lic 372,*
*Adresa Rr Jordan Misja, Pallati Sara-El, Ap1/1, Tirane, email albauditing@yahoo.com*

GJOKA KONSTRUKSION SHA
J91815014U

# PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR

| | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| ***AKTIVE*** | | |
| ***Aktive afat gjate*** | | |
| *Aktive afat gjate materiale* | 903,648,242 | 674,770,174 |
| *Te tjera aktive afta gjate* | 1,810,115,829 | 858,716 |
| | **2,713,764,071** | **675,628,890** |
| ***Aktive qarkulluese*** | | |
| *Inventari* | 1,148,280 | 1,587,332 |
| *Kliente (neto)* | 6,395,828,047 | 3,979,973,118 |
| *Kerkesa te tjera te arketueshme* | 845,586,396 | 775,805,317 |
| *Parapagime dhe shpenzime te shtyra* | | |
| *Likuiditete* | 34,776,041 | 685,909,324 |
| | **7,277,338,764** | **5,443,275,092** |
| ***TOTALI I AKTIVEVE*** | **9,991,102,835** | **6,118,903,981** |
| ***KAPITALET E VETA*** | | |
| *Kapitali* | 2,700,308,550 | 400,332,375 |
| *Kapitali qe I perket aksionereve te shoqerise meme (perdoret vetem ne PF te konsoliduara)* | 9,166,603 | (16,555,474) |
| *Rezerva te tjera* | 9,927,164 | 1,705,530,980 |
| *Rezerva ligjore* | 180,697,594 | 59,515,667 |
| *Rezerva rivleresimi* | | |
| *Fitim (humbje) të pa shperndara* | | |
| *Fitim (humbje) e vitit ushtrimor* | 1,866,306,371 | 728,696,134 |
| ***TOTALI I KAPITALIT*** | **4,766,406,282** | **2,877,519,682** |
| ***DETYRIME*** | | |
| ***Detyrime afat gjate*** | | |
| *Hua afat gjate* | 791,000,000 | |
| *Grante dhe te ardhura te shtyra* | 8,435,750 | - |
| | **799,435,750** | **0** |
| ***Detyrime afat shkurter*** | | |
| *Llogari te pagueshme (furniture)* | 3,426,710,685 | 2,427,564,428 |
| *Kesti afat shkurter i huase afat gjate* | | |
| *Hua afat shkurter* | *99,409,412* | *93,138,071* |
| *Te drejta dhe detyrime ndaj pjesetareve te tjere dhe ortakeve* | 449,568,488 | 493,518,241 |
| *Te tjera detyrime afat shkurter ndaj punonjesve dhe tatimoreve* | 247,509,552 | 32,356,005 |
| *Provizionet afatshkurtra* | 3,316,088 | 3,316,088 |
| *Parapagimet e Arketuara* | 198,746,578 | 191,491,465 |
| | **4,425,260,803** | **3,241,384,299** |
| ***TOTALI I DETYRIMEVE*** | **5,224,696,553** | **3,241,384,299** |
| ***TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE*** | **9,991,102,835** | **6,118,903,981** |
| | | (0) |

GJOKA KONSTRUKSION SHA
J918150140

## PASQYRA E KONSOLIDUAR E TE ARDHURAVE GJITHPERFSHIRESE

| | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| Shitje neto | 6,654,624,620 | 4,480,053,909 |
| Te ardhura tjera | 36,617,831 | 21,326,462 |
| | **6,691,242,451** | **4,501,380,371** |
| Shpenzime operacionale | (2,030,479,719) | (1,806,214,084) |
| Paga sigurime shoqerore dhe shendetesore | (243,573,525) | (214,696,162) |
| Amortizimi | (244,734,075) | (113,232,426) |
| Te tjera shpenzime | (1,895,719,891) | (1,498,216,699) |
| | **(4,474,507,210)** | **(3,632,359,371)** |
| **Rezultati nga aktiviteti kryesor** | **2,216,735,241** | **869,021,000** |
| Te ardhura (shpenzime) per interesa huaje | 2,534,827 | (4,069,454) |
| Humbje nga diferenca konvertimi | (22,881,197) | (7,511,746) |
| Te ardhura (shpenzime) financiare | - | - |
| ***Shpenzime financiare - neto*** | **(20,346,370)** | **(11,581,200)** |
| **Fitimi përpara tatimit** | **2,196,388,871** | **857,439,800** |
| Tatim fitimi | 330,082,500 | 128,743,666 |
| **Fitimi (humbje) neto për periudhën** | **1,866,306,371** | **728,696,134** |
| Diferenca konvertimi nga operacionet jashtë njesisë | | |
| Rivlerësime të pasurive të paluajtshme | | |
| Tatim mbi të ardhurat gjithëpërfshirëse | | |
| **Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse (neto nga tatimi)** | | |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën** | | |

| | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| **Fitim i atribuar për:** | | |
| Aksionerët e Shoqerisë | 1,866,306,371 | 728,696,134 |
| Te tjera aksione në minorance | | - |
| **Fitimi i periudhës** | **1,866,306,371** | **728,696,134** |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse i atribuar për:** | | |
| Aksioneret e Shoqerisë | 1,866,306,371 | 728,696,134 |
| Te tjera aksione në minorance | | - |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirese për periudhën** | **1,866,306,371** | **728,696,134** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MFE - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE - DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT - DREJTORIA E TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ

GJOKA KONSTRUKSION SHA
J91815014U

## PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE MONETARE

| | Pasqyra e fluksit monetar - Metoda direkte | 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|
| | **Fluksi I parave nga veprimtarite e shfrytezimit** | | |
| 1 | *Parate e arketuara nga klientet* | 3,985,537,650 | 4,797,631,506 |
| 2 | *Parate e paguara ndaj furnitoreve dhe punonjesve* | (3,191,963,379) | (3,652,614,050) |
| 3 | Parate te ardhura/paguara nga veprimtarite | | 97,785 |
| 4 | Interes I paguar | 3,188,330 | (4,947,591) |
| 5 | Tatim mbi fitimin i paguar | (1,032,584,862) | (524,534,931) |
| **A** | **Shuma (Para neto nga veprimtarite e shfrytezimit)** | **(235,822,261)** | **615,632,718** |
| | **Fluksi I parave nga veprimtarite investuese** | | |
| 1 | Pagese per blerje te kompanive te kontrolluara | | |
| 2 | Pagese per blerje e aktiveve aftagjata materiale | (307,530,517) | (658,621) |
| 3 | Arketimet nga shitja e pajisjeve | | 99,716,299 |
| 4 | Interes I arketuar | 8,821,819 | 7,595,599 |
| 5 | Dividentet e Arketuar | | |
| **B** | **Para neto te perdorura ne veprimtarite investuese** | **(298,708,698)** | **106,653,276** |
| | **Fluksi monetar nga aktivitetet financiare** | | |
| 1 | Arketime nga emetimi I kapitalit aksionar | | |
| 2 | Arketime nga huamarrje afatgjata | (38,482,356) | |
| 3 | Pagesat e detyrimeve te pagesave te qirave financiare | | (15,107,345) |
| 4 | Dividente te paguar | (78,116,537) | (20,326,464) |
| **C** | **Paraja neto e perdorur ne veprimtarite financiare** | **(116,598,893)** | **(35,433,809)** |
| | Pagesa te pacaktuara | (3,431) | (2,055,051) |
| | **Rritja / Renia neto e mjeteve monetare** | **(651,133,283)** | **684,797,134** |
| | **Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel** | **685,909,324** | **1,112,190** |
| | **Mjetet monetare ne fund te perudhes kontabel** | **34,776,041** | **685,909,324** |

GJOKA KONSTRUKSION SHA
J91815014U

# PASQYRA E NDRYSHIMIT TE KAPITALIT E KONSOLIDUAR

Kapitali aksionar qe i perket aksionareve te shoqerise meme

| | Kapitali aksionar | Primi i aksionit | Aksionet e thesarit | Rezerva statutore dhe ligjore | Rezerva te konvertimit te monedhave te huaja | Fitimi i pashperndare | Rezerva te tjera | Shuma te parashikua ra per rreziqe | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni me 31 Dhjetor 2017** | **400,332,375** | **-** | **-** | **59,515,667** | **(16,555,474)** | **728,696,134** | **1,705,530,980** | **-** | **2,877,519,682** |
| Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel | | | | | | | | | |
| **Pozicioni i rregulluar** | **400,332,375** | **-** | **-** | **59,515,667** | | **728,696,134** | **1,705,530,980** | **-** | **2,894,075,156** |
| Fitimi neto i periudhes kontabel | | | | | | 1,866,306,371 | | | **1,866,306,371** |
| Efekte te ndryshimeve te kurseve te kembimit gjate konsolidimit | (23,825) | | | | 9,166,603 | | (3,118,023) | | **6,024,755** |
| Dividentet e paguar/deklaruar | | | | | | | | | - |
| Transferime ne rezerven e detyrueshme ligjore | | | | - | | | | | - |
| Transferime ne rezerven e detyrueshme statutore | | | | | | | | | - |
| Transferime ne rezerva te tjera | | | | 121,181,927 | | (36,696,134) | (84,485,793) | | - |
| Emetimi i kapitalit aksionar | 2,300,000,000 | | | | | (692,000,000) | (1,608,000,000) | | - |
| Rezerva rivleresimi i AAGJ | | | | | | | | | - |
| Transferim ne detyrimet | | | | | | | | - | - |
| Blerje aksionesh thesari | | | | | | | | | - |
| Terheqje kapitali per zvogelim | - | | | | | | | | - |
| **Pozicioni me 31 Dhjetor 2018** | **2,700,308,550** | **-** | **-** | **180,697,594** | **9,166,603** | **1,866,306,371** | **9,927,164** | **-** | **4,766,406,282** |

GJOKA KONSTRUKSION SHA
J91815014U

# PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

| | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| ***AKTIVE*** | | |
| ***Aktive afat gjate*** | | |
| *Aktive afat gjate materiale* | 903,648,242 | 674,770,174 |
| *Te tjera aktive afta gjate* | 1,810,115,829 | 858,716 |
| | **2,713,764,071** | **675,628,890** |
| ***Aktive qarkulluese*** | | |
| *Inventari* | 1,148,280 | 1,587,332 |
| *Kliente (neto)* | 6,346,879,375 | 3,975,840,235 |
| *Kerkesa te tjera te arketueshme* | 845,586,396 | 775,805,317 |
| *Parapagime dhe shpenzime te shtyra* | | |
| *Likujditete* | 12,194,960 | 685,861,462 |
| | **7,205,809,011** | **5,439,094,346** |
| ***TOTALI I AKTIVEVE*** | **9,919,573,082** | **6,114,723,236** |
| ***KAPITALET E VETA*** | | |
| *Kapitali* | 2,700,000,000 | 400,000,000 |
| *Rezerva te tjera* | | 1,692,485,793 |
| *Rezerva ligjore* | 180,697,594 | 59,515,667 |
| *Rezerva rivleresimi* | | |
| *Fitim (humbje) të pa shperndara* | | |
| *Fitim (humbje) e vitit ushtrimor* | 1,859,625,571 | 728,696,134 |
| ***TOTALI I KAPITALIT*** | **4,740,323,165** | **2,880,697,595** |
| ***DETYRIME*** | | |
| ***Detyrime afat gjate*** | | |
| *Hua afat gjate* | 791,000,000 | |
| *Grante dhe te ardhura te shtyra* | 8,435,750 | - |
| | **799,435,750** | - |
| ***Detyrime afat shkurter*** | | |
| *Llogari te pagueshme (furniture)* | 3,382,183,891 | 2,420,205,770 |
| *Kesti afat shkurter i huase afat gjate* | | |
| *Hua afat shkurter* | 99,409,412 | 93,138,071 |
| *Te drejta dhe detyrime ndaj pjesetareve te tjere dhe ortakeve* | 449,568,488 | 493,518,241 |
| *Te tjera detyrime afat shkurter ndaj punonjesve dhe tatimoreve* | 246,589,710 | 32,356,005 |
| *Provizionet afatshkurtra* | 3,316,088 | 3,316,088 |
| *Parapagimet e Arketuara* | 198,746,578 | 191,491,466 |
| | **4,379,814,167** | **3,234,025,641** |
| ***TOTALI I DETYRIMEVE*** | **5,179,249,917** | **3,234,025,641** |
| ***TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE*** | **9,919,573,082** | **6,114,723,236** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE - DREJTORIA E SHERBIMIT TE TATIMPAGUESVE

**GJOKA KONSTRUKSION SHA**
**J91815014U**

## PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHPERFSHIRESE

| | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| Shitje neto | 6,443,726,106 | 4,480,053,909 |
| Te ardhura tjera | 36,617,831 | 21,326,462 |
| | **6,480,343,937** | **4,501,380,371** |
| Shpenzime operacionale | (1,890,12[illegible],116) | (1,806,214,084) |
| Paga, sigurime shoqerore dhe shendetesore | (240,962,279) | (214,696,162) |
| Amortizimi | (244,734,075) | (113,232,426) |
| Te tjera shpenzime | (1,895,645,990) | (1,498,216,699) |
| | **(4,271,468,460)** | **(3,632,359,371)** |
| **Rezultati nga aktiviteti kryesor** | **2,208,875,477** | **869,021,000** |
| Te ardhura (shpenzime) per interesa huaje | 2,534,827 | (4,069,454) |
| Fitim /Humbje nga diferenca konvertimi | (22,881,197) | (7,511,746) |
| Te ardhura (shpenzime) financiare | - | - |
| **Shpenzime financiare- neto** | **(20,346,370)** | **(11,581,200)** |
| **Fitimi përpara tatimit** | **2,188,529,107** | **857,439,800** |
| Tatim fitimi | 328,903,536 | 128,743,666 |
| **Fitimi (humbje) neto për periudhën** | **1,859,625,571** | **728,696,134** |
| Diferenca konvertimi nga operacionet jashtë njesisë | | |
| Rivlerësime të pasurive të paluajtshme | | |
| Tatim mbi të ardhurat gjithëpërfshirëse | | |
| **Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse (neto nga tatimi)** | | |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën** | | |

| | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| **Fitim i atribuar për:** | | |
| Aksionerët e Shoqerisë | 1,859,625,571 | 728,696,134 |
| Te tjera aksione në minorance | - | - |
| **Fitimi i periudhës** | **1,859,625,571** | **728,696,134** |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse i atribuar për:** | | |
| Aksioneret e Shoqerisë | 1,859,625,571 | 728,696,134 |
| Te tjera aksione në minorance | - | - |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirese për periudhën** | **1,859,625,571** | **728,696,134** |

GJOKA KONSTRUKSION SHA
J91815014U

# PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

| **Pasqyra e fluksit monetar - Metoda direkte** | **2018** | **2017** |
|---|---|---|
| **Fluksi I parave nga veprimtarite e shfrytezimit** | | |
| *Parate e arketuara nga klientet* | 3,689,349,563 | 4,797,631,506 |
| *Parate e paguara ndaj furnitoreve dhe punonjesve* | (2,995,225,410) | (3,652,614,050) |
| Parate te ardhura/paguara nga veprimtarite | | 97,785 |
| Interes I paguar | 3,188,330 | (4,947,591) |
| Tatim mbi fitimin i paguar | (994,153,750) | (524,534,931) |
| **Shuma (Para neto nga veprimtarite e shfrytezimit)** | **(296,841,267)** | **615,632,718** |
| **Fluksi I parave nga veprimtarite investuese** | | |
| Pagese per blerje te kompanive te kontrolluara | | |
| Pagese per blerje e aktiveve aftagjata materiale | (307,530,517) | (658,621) |
| Arketimet nga shitja e pajisjeve | | 99,716,299 |
| Interes I arketuar | 8,821,819 | 7,595,599 |
| Dividentet e Arketuar | | |
| **Para neto te perdorura ne veprimtarite investuese** | **(298,708,698)** | **106,653,276** |
| **Fluksi monetar nga aktivitetet financiare** | | |
| Arketime nga emetimi i kapitalit aksionar | | |
| Arketime nga huamarrje afatgjata | | |
| Pagesat e detyrimeve te pagesave te qirave financiare | | (15,107,345) |
| Dividente te paguar | (78,116,537) | (20,326,464) |
| **Paraja neto e perdorur ne veprimtarite financiare** | **(78,116,537)** | **(35,433,809)** |
| Pagesa te pacaktuara | | (2,054,230) |
| **Rritja / Renia neto e mjeteve monetare** | **(673,666,502)** | **684,797,955** |
| **Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel** | **685,861,462** | **1,063,507** |
| **Mjetet monetare ne fund te perudhes kontabel** | **12,194,960** | **685,861,462** |

GJOKA KONSTRUKSION SHA
J91815014U

# PASQYRA E NDRYSHIMIT TE KAPITALIT INDIVIDUALE

Kapitali aksionar qe i perket aksionareve te shoqerise meme

| | Kapitali aksionar | Primi i aksionit | Aksione te thesarit | Rezerva statutore dhe ligjore | Rezerva te konvertimit te monedhave te huaja | fitimi i pashperndare | Rezerva te tjera | shuma te parashikuara per rreziqe | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni me 31 Dhjetor 2017** | 400,000,000 | - | - | 59,515,667 | - | 728,696,134 | 1,692,485,793 | - | 2,880,697,595 |
| Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel | | | | | | | | | |
| **Pozicioni i rregulluar** | 400,000,000 | - | - | 59,515,667 | - | 728,696,134 | 1,692,485,793 | - | 2,880,697,594 |
| Fitimi neto i periudhes kontabel | | | | | | 1,859,625,571 | | | 1,859,625,571 |
| Efekte te ndryshimeve te kurseve te kembimit gjate konsolidimit | | | | | | | | | |
| Dividentet e paguar/deklaruar | | | | | | | | | - |
| Transferime ne rezerven e detyrueshme ligjore | | | | | | | | | - |
| Transferime ne rezerven e detyrueshme statutore | | | | | | | | | - |
| Transferime ne rezerva te tjera | | | | 121,181,927 | | (36,696,134) | (84,485,793) | | - |
| Emetimi i kapitalit aksionar | 2,300,000,000 | - | | | | (692,000,000) | (1,608,000,000) | | - |
| Rezerva rivleresimi i AAGJ | | | | | | - | | | - |
| Transferim ne detyrimet | | | | | | | | - | - |
| Blerje aksionesh thesari | | | - | | | | | | - |
| Terheqje kapitali per zvogelim | - | | | | | | | | - |
| **Pozicioni me 31 Dhjetor 2018** | 2,700,000,000 | - | - | 180,697,594 | - | 1,859,625,571 | - | - | 4,740,323,165 |

Gjoka Konstruksion perfaqesia KOSOVE
Numri I Biznesit: 600232475

## BILANCI I GJENDJES

| | Shuma ne Euro 31.12.18 | Kursi 1 Euro=123.42 Shuma ne ALL 31.12.18 | Shuma ne Euro 31.12.17 | Kursi 1 Euro=132.95 Shuma ne ALL 31.12.17 |
|---|---|---|---|---|
| **Mjetet Xhiruese** | | | | |
| Para te gatshme ne llog rrjedhese | 182,701 | 22,548,992 | 100 | 13,295 |
| Paraja ne arke Cash | 260 | 32,089 | 260 | 34,567 |
| | | - | | - |
| Llogari te arketueshme Bleresit | 7,313 | 902,591 | 10,362 | 1,377,628 |
| Llogari te arketueshme garanci punimesh | 201,637 | 24,886,025 | | |
| Paradhenie dhe huazime per shoqerine meme | 2,907,175 | 358,803,539 | 2,595,375 | 345,055,106 |
| Parapagime per mallra dhe sherbime | 187,652 | 23,160,056 | 3,037 | 403,769 |
| Paradhenie per keste tatimesh | - | - | 7,892 | 1,049,241 |
| TVSH e zbritshme | | - | 9,795 | 1,302,245 |
| | **3,486,739** | **430,333,292** | **2,626,821** | **349,235,852** |
| **Mjetet themelore te trupezuara** | | | | |
| Uzinat, makineria dhe Paisjet | - | - | - | - |
| Zhvleresim I akumuluar | - | - | - | - |
| | - | - | - | - |
| **GJITHSEJ MJETET** | **3,486,739** | **430,333,292** | **2,626,821** | **349,235,852** |
| **DETYRIMET** | | | | |
| **Detyrimet afatshkurtra** | | | | |
| Llogarite e Pagueshme ndaj furnitoreve te brendshem | 2,589,449 | 319,589,736 | 2,517,820 | 334,744,169 |
| Llogarite e Pagueshme ndaj furnitoreve te jashtem | 8,380 | 1,034,260 | 8,380 | 1,114,121 |
| Ndalesa per garanci punimesh | 162,335 | 20,035,360 | | |
| Detyrime ndaj parapagimeve te pranuara | 582,058 | 71,837,580 | | |
| Detyrime ne paga | - | - | - | - |
| Detyrime ndaj tatimeve | 4,269 | 526,855 | | |
| | **3,346,490** | **413,023,791** | **2,526,200** | **335,858,290** |
| **KAPITALET E VETA** | | | | |
| **Kapitalet e Veta** | | | | |
| Kapitali I Pronarit | 82,934 | 10,235,714 | 151,043 | 20,081,167 |
| Fitim (Humbja) e vitit vijues | - | - | (50,422) | (6,703,605) |
| Fitimi NETO nga PASH | 57,315 | 7,073,786 | - | - |
| | **140,249** | **17,309,501** | **100,621** | **13,377,562** |
| **Gjithsej detyrimet, dividenda dhe kapitalet e veta** | **3,486,739** | **430,333,292** | **2,626,821** | **349,235,852** |
| | - | - | - | - |

Gjoka Konstruksion perfaqesia KOSOVE
Numri I Biznesit: 600232475

## Pasqyra e Tatimit ne Fitim

| | Shuma ne Euro 31.12.18 | Kursi 1 Euro=123.42 Shuma ne ALL 31.12.18 | Shuma ne Euro 31.12.17 | Kursi 1 Euro=132.95 Shuma ne ALL 31.12.17 |
|---|---|---|---|---|
| **Te hyrat** | | | | |
| Te hyrat nga shitja | 1,708,787 | 210,898,514 | | - |
| | **1,708,787** | **210,898,514** | - | - |
| **Kostoja e shitjes** | | | | |
| Kostoja e mallit te shitur | 1,623,348 | 200,353,603 | | |
| | **1,623,348** | **200,353,603** | - | - |
| **Fitimi Bruto** | **85,439** | **10,544,911** | - | - |
| **Shpenzimet Operative** | | | | |
| Shpenzimet e shitjes dhe administrates | 21,756 | 2,685,148 | | |
| | **21,756** | **2,685,148** | - | - |
| **Zhvleresimi** | | | | |
| Zhvleresimi | - | - | - | - |
| | - | - | - | - |
| **Total Shpenzime** | **21,756** | **2,685,148** | - | - |
| **Fitimi Humbja Operative** | **63,683** | **7,859,763** | - | - |
| **Te hyra te tjera** | | | | |
| Te hyra financiare | - | - | | |
| | - | - | - | - |
| Shpenzime te tjera | - | - | | - |
| Shpenzime te tjera te papranuara | - | - | | - |
| **Fitimi humbja para tatimit** | **63,683** | **7,859,763** | - | - |
| Tatimi 10%: | 6,368 | 785,976 | - | - |
| **Fitimi / humbja e periudhes:** | **57,315** | **7,073,787** | - | - |

Gjoka Konstruksion perfaqesia KOSOVE
Numri I Biznesit: 600232475

## CASH FLOW

| | Shuma ne Euro 31.12.18 | Kursi 1 Euro=123.42 Shuma ne ALL 31.12.18 | Shuma ne Euro 31.12.17 | Kursi 1 Euro=132.95 Shuma ne ALL 31.12.17 |
|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti kryesor** | | | | |
| Hyrjet nga klientet | 2,399,839 | 296,188,087 | | - |
| Dalje per pagesen e furnitoreve dhe punetorei | (1,594,053) | (196,737,969) | | - |
| Tatime te paguara | (311,385) | (38,431,112) | | - |
| **Gjithsej aktiviteti kryesor** | **494,401** | **69,315,059** | **-** | **-** |
| **Aktiviteti Financiar** | | - | | - |
| Huazimet Afatshkurtra | (311,800) | (38,482,356) | - | - |
| **Gjithsej Aktiviteti Financiar** | **(311,800)** | **(38,482,356)** | | |
| **Neto nga aktivitetet** | **182,601** | **30,832,703** | **-** | **-** |
| **Gjendja fillestare** | **360** | **44,431** | **360** | **47,862** |
| | | - | | - |
| **Gjendja e tanishme** | **182,961** | **22,581,081** | **360** | **47,862** |

Gjoka Konstruksion perfaqesia KOSOVE
Numri I Biznesit: 600232475

| Kapitalet e veta-Ekuiteti | Shuma ne Euro 31.12.18 | Kursi 1 Euro=123.42 Shuma ne ALL 31.12.18 | Shuma ne Euro 31.12.17 | Kursi 1 Euro=132.95 Shuma ne ALL 31.12.17 |
|---|---|---|---|---|
| Kapitali I Pronarit | 2,500 | 308,550 | 2,500 | 332,375 |
| Fitimi I mbartur ne vite | 80,434 | 9,927,164 | 148,543 | 19,748,792 |
| Humbje Kapitale | - | - | (50,422) | (6,703,605) |
| E Ardhura NETO nga pasqyra Financiare | 57,315 | 7,073,787 | - | - |
| | 140,249 | 17,309,501 | 100,621 | 13,377,562 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE DREJTORIA E SHERBIMIT PER TATIMPAGUESIT E MEDHENJ MFE DREJTORIA E TATIMPAGUESVE TE MEDHENJ